

Statistikat afatshkurtra

Tremujori I, 2014

Tiranë, më 02 Korrik: Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike, publikojnë të dhënat e tremujorit të parë 2014 sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 e cila zëvendëson Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev 1.1. Në mënyrë që të reflektohen ndryshimet e ndodhura në strukturën e ekonomisë, të gjithë treguesit në këtë tremujor paraqiten me bazë të përditësuar, nga 2005 në 2010. Anketa mbulon në mënyrë të përmblodhur tre aktivitete kryesore: Industri, Ndërtim, dhe Shërbime (përfshi aktivitetin “Tregti”). *(Shih shënime metodologjike, fq.15).*

Indeksi i volumit të shifrës së afarizmit të deflatuar, vlerësuar me çmime fikse (2010=100) arriti 102,6 % në tremujorin e parë 2014.

Në ndryshimin vjetor ky tregues pasqyron rritje prej 1,7 % në aktivitetet ekonomike të mbuluara në vrojtimin tremujor, krahasuar me tremujorin e parë 2013. Ky ndryshim në të njëjtin tremujor të vitit 2013 ishte 1,2 %. Në këtë rritje ndikojnë aktivitetet që kryhen në sektorët “Industri” dhe “Shërbime”, përkatësisht me 3,8 % dhe 4,0 %.

Në aktivitetin “Industri”, ndikon me 18,0 % rritja e treguesit të shifrës së afarizmit në volum, e deflatuar, në Industrinë Nxjerrëse. Ky tregues në aktivitetet “Energji elektrike, gaz, avull dhe furnizim me ajër të kondicionuar” dhe “ Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë” paraqitet me rënie përkatësisht 3,2 % dhe 2,6 %. Aktiviteti i ndërtimit në këtë tremujor pasqyron gjithashtu rënie të këtij treguesi me 4,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Në rritjen prej 4,0 % të shifrës së afarizmit në volum, e deflatuar, në “Shërbime”, në tremujorin e parë 2014 krahasuar me tremujorin e parë 2013, kanë ndikuar kryesisht aktivitetet si “Tregti” me një rritje prej 3,9 %, “Aktivitete të postës dhe korrierës” me 9,6 %, “Informacioni dhe Telekomunikacioni” me 19,2 %, Agjencitë e udhëtimit” me 30,7 %. Në fushën e Shërbimeve, ky tregues paraqitet me 2,2 %, ulje në aktivitetet si “Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve”, “Transporti ujqor” me 8,5 %, “Hotele” 4,3 %, dhe “Komunikacioni” me 2,5 %.

Ndryshimi tremujor i treguesit të shifrës së afarizmit në volum, deflatuar, në tremujorin e parë 2014, paraqitet me rënie prej 20,8 %. Rënia vjen kryesisht nga aktivitetet si “Industri nxjerrëse” me 18,5 %, “Industri Përpunuese” me 12,9 %, “Ndërtim” me 29,2 %.

Në krahasim me tremujorin e katërt 2013, në aktivitetet e Shërbimeve shifra e afarizmit në volum, e deflatuar, pasqyron rënie me 24,0 % si rezultat i uljes së këtij treguesi në “Tregti me shumicë” me 29,9 %, në “Hotele” 16,2 %, në “Agjenci Udhëtimi” 14,9 %, etj.

Treguesit si “Numri mesatar i të punësuarve me pagesë” dhe “Paga”, pasqyrojnë rritje në tremujorin e parë 2014 në krahasim me tremujorin e parë 2013, përkatësisht 8,6 % dhe 5,4 %. Ndërsa, ndryshimi tremujor në treguesit e Numrit mesatar të të punësuarve me pagesë, paraqitet me rritje 9,2 %, ndërsa pagat me rënie 2,1 %, krahasuar me tremujorin paraardhës.

Fig. 1 Indeksi i shifrës së afarizmit në volum (e deflatuar) në Industri, Ndërtim, dhe Shërbime, Tr.I – ‘05 – Tr.I - ‘14



Tab. 1 Ndryshimi vjetor i shifrës së afarizmit në volum (e deflatuar), T.I '13 – T.I '14

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Përshkrimi	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
		I - 12	II - 12	III - 12	IV - 12	I - 13
	Aktivitetet ekonomike gjithsej	1,2	5,7	0,6	7,7	1,7
B+C	Industri	15,3	2,3	-1,9	11,3	3,8
B	Industri Nxjerrëse	39,8	41,6	33,5	68,2	18,0
C	Industri Përpunuese	10,0	-6,4	-9,7	-1,5	0,2
D	Prodhim dhe Shpërndarje energji, avull	23,8	41,4	14,8	14,0	-3,2
E	Prodhim dhe furnizim me ujë	33,1	31,9	38,2	40,0	-2,6
F	Ndërtim	-24,3	6,0	-16,3	-9,3	-4,9
G - N	Shërbime	-0,8	2,5	3,6	9,7	4,0
G	Tregti	-2,4	2,9	4,1	11,8	3,9
H (49-53)	Transport dhe magazinim	19,7	16,8	18,9	-22,7	-36,2
I (551)	Hotele dhe struktura të ngjashme	16,6	-3,7	-14,3	-22,0	-4,3
J (58-62)	Informacioni dhe komunikimi	17,1	-13,5	-15,9	4,5	19,2
M (71)	Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	37,6	29,6	70,0	59,8	57,7
N (79)	Agjenci udhëtimi, operator turistik	-20,6	-18,7	3,3	41,4	30,7

Tab. 2 Shifra e afarizmit në volum (e deflatuar), ndryshimi tremujor

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Përshkrimi	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
		IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13
	Aktivitetet ekonomike gjithsej	-16,2	12,0	6,3	7,9	-20,8
B+C	Industri	-8,8	11,8	2,7	6,2	-14,9
B	Industri nxjerrëse	16,1	16,7	1,0	22,9	-18,5
C	Industri përpunuese	-14,4	10,3	3,3	1,0	-12,9
D	Energjia	33,2	-6,1	-17,3	10,2	13,1
E	Prodhim dhe furnizim me ujë	26,9	-3,7	12,9	1,5	-12,7
F	Ndërtim	-32,5	39,0	-20,4	21,4	-29,2
G - N	Shërbime	-19,9	9,9	17,8	5,9	-24,0
G	Tregti	-20,0	11,1	17,2	6,6	-25,6
H (49-53)	Transport	-5,2	10,3	23,6	-40,2	-21,8
I (551)	Hotele dhe struktura të ngjashme	-31,7	13,9	8,0	-7,2	-16,2
J (58-62)	Informacion dhe komunikim	-29,5	-9,6	22,2	34,1	-19,5
M (71)	Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	22,6	11,2	10,2	6,4	21,0
N (79)	Agjenci udhëtimi, operator turistik	-7,9	14,1	17,8	14,2	-14,9

Industria

Në tremujorin e parë 2014, shifra e afarizmit në volum, e deflatuar, është rritur 3,8 % në "Industri" (përfshi Industri Nxjerrëse dhe Përpunuese), krahasuar me tremujorin e parë 2013. Në këtë rritje ndikon aktiviteti "Industri Nxjerrëse" me 18,0 %. Ndërsa, në aktivitetet "Energji elektrike, gaz, avull dhe furnizim me ajër të kondicionuar" dhe "Grumbullim, trajtim dhe furnizim me ujë" paraqiten me rënie, në mënyrë respektive, me 3,2 % dhe 2,6 %.

Volumi i prodhimit industrial shënoi një rritje prej 21,3 % në tremujorin e parë 2014, ndërsa volumi i prodhimit të Energjisë elektrike ka rënë me 18,0 % duke ju referuar të njëjtës periudhë krahasimore.

Numri i të punësuarve për aktivitetin "Industri" (Industri Nxjerrëse dhe Përpunuese) u rrit me 13,7 %, krahasuar me tremujorin e parë 2013, ndryshim i cili vjen kryesisht nga rritja e këtij treguesi në "Industri Përpunuese". Për aktivitetet "Energji elektrike, gaz, avull dhe furnizim me ajër të kondicionuar" dhe "Grumbullim, trajtim dhe furnizim me ujë", ky tregues paraqitet respektivisht me ulje prej 0,2 % dhe me rritje prej 3,2 %. Niveli i pagave shënoi një rritje prej 8,8 % në "Industri", 22,3 % në "Energji elektrike, gaz, avull dhe furnizim me ajër të kondicionuar" dhe 9,4 % në "Grumbullim, trajtim dhe furnizim me ujë".

Ndryshimi tremujor i treguesit të shifrës së afarizmit në volum, deflatuar, paraqitet me rënie 14,9 % në Industri. Të dy degët përbërëse si "Industri Nxjerrëse" dhe "Përpunuese" kanë ndikuar në mënyrë respektive në rënie me 18,5 % dhe 12,9 %. Në aktivitetet "Energji elektrike, gaz, avull dhe furnizim me ajër të kondicionuar" dhe në "Grumbullim, trajtim dhe furnizim me ujë", ky tregues rezultoi përkatësisht me rritje prej 13,1 % dhe rënie prej 11,7 %.

Gjatë tremujorit të parë 2014, volumi i prodhimit industrial u rrit me 3,9 %, ndërsa volumi i prodhimit të energjisë u rrit me 14,7 % krahasuar me tremujorin paraardhës.

Me një rritje prej 11,4 % rezultoi numri i të punësuarve për aktivitetin "Industri", rritje e cila vjen kryesisht nga ndikimi i Industrisë Përpunuese. Ky tregues ka një rënie me 2,6 % në Energjinë elektrike, gazin dhe avullin dhe rritje prej 0,6 % në aktivitetin e Grumbullimit dhe furnizimit me ujë. Niveli i pagave shënoi një rënie prej 4,1 % në "Industri", rritje prej 7,0 % në Energji elektrike dhe rënie prej 8,9 % në "Grumbullimi dhe furnizimi me ujë".

Fig. 2 Indeksi i shifrës së afarizmit dhe prodhimit industrial në Industrinë Nxjerrëse dhe Përpunuese




Fig. 3 Indeksi i shifrës së afarizmit në Industri Nxjerrëse, Industri Përpunuese, Energji Elektrike dhe Grumbullimi dhe furnizimi me ujë





Fig. 4 Volumi i prodhimit, Energji Elektrike



Tab. 3 Shifra e afarizmit në volum e deflatuar, ndryshimi vjetor

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
			I - 12	II - 12	III - 12	IV - 12	I - 13
B-C	05-33	Industri	15,3	2,3	-1,9	11,3	3,8
B	05-09	Industri Nxjerrëse	39,8	41,6	33,5	68,2	18,0
C	10-33	Industri Përpunuese	10,0	-6,4	-9,7	-1,5	0,2
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	23,8	41,4	14,8	14,0	-3,2
E	36-39	Grumbullimi e furnizimi me ujë	33,1	31,9	38,2	40,0	-2,6

Tab. 4 Shifra e afarizmit në volum e deflatuar, ndryshimi tremujor

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
			IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13
B-C	05-33	Industri	-8,8	11,8	2,7	6,2	-14,9
B	05-09	Industri Nxjerrëse	16,1	16,7	1,0	22,9	-18,5
C	10-33	Industri Përpunuese	-14,4	10,3	3,3	1,0	-12,9
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	33,2	-6,1	-17,3	10,2	13,1
E	36-39	Grumbullimi e furnizimi me ujë	26,9	-3,7	12,9	1,5	-11,7

Tab. 5 Volumi i prodhimit industrial, ndryshimi vjetor

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE		I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
	Rev.2	Aktiviteti ekonomik	I - 12	II - 12	III - 12	IV - 12	I - 13
B-C	05-33	Industri	24,7	19,3	13,7	25,3	21,3
B	05-09	Industri Nxjerrëse	49,7	45,8	34,4	56,9	20,4
C	10-33	Industri Përpunuese	5,0	-1,5	-2,7	-0,6	20,0
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	118,4	122,6	35,0	87,8	-18,0
E	36-39	Grumbullimi e furnizimi me ujë	-5,4	-2,4	28,6	-8,9	-7,9

Tab. 6 Volumi i prodhimit industrial, ndryshimi tremujor

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE		I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
	Rev.2	Aktiviteti ekonomik	IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13
B-C	05-33	Industri	7,3	10,9	2,4	2,8	3,9
B	05-09	Industri Nxjerrëse	18,8	13,7	2,8	12,9	-8,8
C	10-33	Industri Përpunuese	-1,3	8,0	1,9	-8,5	19,2
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	162,7	43,8	-63,4	35,7	14,7
E	36-39	Grumbullimi e furnizimi me ujë	-11,9	2,2	36,2	-25,7	-11,0

Tab. 7 Numri mesatar i të punësuarve me pagesë, ndryshimi vjetor

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE		I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
	Rev.2	Aktiviteti ekonomik	I - 12	II - 12	III - 12	IV - 12	I - 13
B-C	05-33	Industri	6,9	5,7	9,9	10,3	13,7
B	05-09	Industri Nxjerrëse	23,7	25,0	22,9	18,4	3,1
C	10-33	Industri Përpunuese	4,2	2,5	7,7	8,9	15,4
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	2,2	5,8	8,2	12,0	-0,2
E	36-39	Grumbullimi e furnizimi me ujë	10,1	7,9	11,2	14,8	3,2

Tab. 8 Numri mesatar i të punësuarve me pagesë, ndryshimi tremujor

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
			IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13
B-C	05-33	Industri	8,0	-1,8	0,9	3,0	11,4
B	05-09	Industri Nxjerrëse	18,1	3,9	-1,3	-2,3	2,8
C	10-33	Industri Përpunuese	6,3	-2,8	1,3	4,0	12,7
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	9,3	2,3	1,1	-0,9	-2,6
E	36-39	Grumbullimi e furnizimi me ujë	11,9	-1,8	3,4	1,0	0,6

Ndërtimi


Në sektorin e ndërtimit, shifra e afarizmit në volum, deflatuar, me Indeksin e Kushtimit në Ndërtim, në tremujorin e parë 2014 shënoi një rënie prej 4,9 % krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit paraardhës.

Volumi i ndërtimit paraqitet me një rënie prej 1,2 % krahasuar më tremujorin e parë 2013.

Në tremujorin e parë 2014, shifra e afarizmit në volum, deflatuar, shënoi një rënie prej 29,2 % krahasuar me tremujorin e katërt 2013, ndërsa volumi i ndërtimit është ulur me 28,2 % gjatë së njëjtës periudhë.

Numri i të punësuarve në Ndërtim në tremujorin e parë 2014 paraqitet me një rritje prej 4,5 % krahasuar me tremujorin e parë 2013, ndërsa pagat shënuan një rënie prej 7,3 % gjatë së njëjtës periudhë.

Fig. 5 Indekset e shifrës së afarizimit dhe volumit të ndërtimit



Tab. 9 Shifra afarizmit e deflatuar, Volumi i ndërtimit ,Të punësuar me pagesë , Pagat. Ndryshimi vjetor në përqindje

(2010=100)

(%)

NVE Rev.2	Treguesit	I 2013	II 2013	III 2013	IV 2013	I 2014
		I 2012	II 2012	III 2012	IV 2012	I 2013
41-43	Shifra afarizmit	-24,3	6,0	-16,3	-9,3	-4,9
	Volumi ndërtimit	-31,0	5,5	-15,8	-10,1	-1,2
	Të punësuarit	-7,5	-11,2	-5,8	2,0	4,5
	Pagat	-2,4	-17,2	-5,4	-0,9	-7,3

Tab. 10 Shifra afarizmit e deflatuar, Volumi i ndërtimit,Të punësuar me pagesë, Pagat. Ndryshimi tremujor në përqindje

(2010=100)


(%)

NVE Rev.2	Treguesit	I 2013	II 2013	III 2013	IV 2013	I 2014
		IV 2012	I 2013	II 2013	III 2013	IV 2013
41-43	Shifra afarizmit	-32,5	39,0	-20,4	21,4	-29,2
	Volumi ndërtimit	-34,6	45,0	-18,2	16,0	-28,2
	Të punësuarit	7,6	-5,9	0,4	0,2	10,2
	Pagat	5,1	-9,7	8,8	-4,0	-1,6

Fig. 6 Indeksi i volumit të ndërtimit në Ndërtime të reja, Rikonstruksione dhe Punime inxhinierike

(2010=100)

(%)



Shërbime

Në tremujorin e parë 2014, në aktivitetet përbërëse të sektorit të Shërbimeve gjithsej ndryshimi pozitiv vjetor prej 4,0 % të shifrës së afarizmit në volum, e deflatuar, krahasuar me tremujorin e parë 2013, vjen nga rritja 30,7 % në aktivitetin “Agjenci Udhëtimi, 19,2 % në aktivitetin “Informacioni dhe Komunikacioni” dhe 3,2 % në “Tregti me shumicë”.

Si rezultat i zbatimit të klasifikimit të ri, NVE Rev.2, aktivitetet që i përkojnë sektorit të Shërbimeve me kodet përkatëse strukturohen si më poshtë:

- Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (45) dhe Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave (46)
- Transporti dhe Magazinimi (përfshirë dhe Aktiviteti Postar dhe korrierës) (49-53)
- Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor, Hotele (55.1)
- Informacioni dhe Komunikacioni (58, 61, 62)
- Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike (71)
- Shërbime administrative dhe mbështetëse – Agjencitë e udhëtimit (79)

Aktiviteti “Tregti me shumicë” paraqet 3,2 % rritje të shifrës së afarizmit në volum, e deflatuar, në tremujorin e parë 2014 krahasuar me tremujorin e parë 2013. Ndërsa, aktiviteti “Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve”, për të njëjtën periudhë krahasimi paraqitet me rënie 2,2 %.

Ndryshimi tremujor për aktivitetin “Tregti me shumicë” paraqitet me rënie 29,9 %, ndërsa “Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve” paraqitet me rënie 3,1 %, në tremujorin e parë 2014 në krahasim me tremujorin paraardhës.

Në aktivitetet “Transporti dhe Magazinimi”, shifra e afarizmit në volum, e deflatuar, ulet 36,2 %, në tremujorin e parë 2014 krahasuar me tremujorin e parë 2013. Ndikimi vjen nga rënia 17,5 % e volumit të shitjeve në Transportin Hekurudhor dhe 8,5 % në Transportin ujor. Paraqitet me rritje 9,6 %, shifra e afarizmit në volum, të deflatuar, në Aktivitetin e Postës dhe Korrierës.

Ndryshimi tremujor i shifrës së afarizmit në volum, të deflatuar për aktivitetet në “Transport dhe Magazinim”, është ulur 21,8 %, ndikuar nga rënia prej 7,9 % në aktivitetin “Transport Ujor”, prej 19,3 %

nga aktiviteti “Magazinin” dhe 8,8 % nga Aktiviteti Postës dhe korrierës, krahasuar me tremujorin paraardhës.

Në seksionin “Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor”, anketa tremujore mbulon vetëm aktivitetin e Hoteleve, ku shifra e afarizmit në volum, e deflatuar, ulet 4,3 % në tremujorin e parë 2014 krahasuar me tremujorin e parë 2013. Ndryshimi me tremujorin e katërt 2013, i shifrës së afarizmit në volum në aktivitetin Hotelier paraqet rënie prej 16,2 %.

Shifra e afarizmit në volum, e deflatuar, në seksionin “Informacioni dhe Komunikacioni”, është rritur 19,2 % në tremujorin e parë 2014 krahasuar me tremujorin e parë 2013.

Ndryshimi në tremujorin e parë 2014, i këtij treguesi paraqitet me 19,5 % rënie në aktivitetin “Informacioni dhe Komunikacioni”, krahasuar me tremujorin paraardhës.

Në seksionin “Shërbime administrative dhe Mbështetëse”, anketa tremujore mbulon vetëm aktivitetin e Agjencive të Udhëtimit, ku shifra e afarizmit në volum, e deflatuar, rritet 30,7 % në tremujorin e parë 2014 krahasuar me tremujorin e parë 2013.

Ndryshimi në tremujorin e parë 2014, i shifrës së afarizmit në volum, e deflatuar, në aktivitetin “Agjenci Udhëtimi” ulet 14,9 % krahasuar me tremujorin paraardhës.

Në seksionin “Aktivitete Profesionale, Shkencore dhe Teknike”, anketa tremujore mbulon vetëm Aktivitetet e Arkitekturës dhe Inxhinierike, ku shifra e afarizmit në volum, e deflatuar, rritet 57,7 % në tremujorin e parë 2014 krahasuar me tremujorin e parë 2013.

Ndryshimi në tremujorin e parë 2014, i këtij treguesi paraqet rritje me 21,0 % në “Aktivitete të Arkitekturës dhe Inxhinierike”, krahasuar me tremujorin paraardhës.

Në tremujorin e parë 2014, në sektorin Shërbime ka pasur një rritje të numrit mesatar të të punësuarve me pagesë me 6,7 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ndërsa pagat janë rritur 4,8%. Krahasuar me tremujorin e katërt të 2013 punësimi paraqet një rritje 8,6 % ndërsa pagat janë ulur 0,7%.

Tab. 11 Shifra e afarizmit në volum (e deflatuar), ndryshimi vjetor

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
		I - 12	II - 12	III - 12	IV - 12	I - 13
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi I automjeteve dhe motoçikletave	8,2	4,3	1,1	-3,1	-2,2
G(46)	Tregtia me shumicë	-6,1	2,3	5,8	15,0	3,2
H(49-53)	Transport dhe Magazininim	19,7	16,8	18,9	-22,7	-36,2
I(5500)	Hotele	16,6	-3,7	-14,3	-22,0	-4,3
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe Komunikacioni	17,1	-13,5	-15,9	4,5	19,2
M(71)	Aktivitete të Arkitekturës dhe Inxhinierike	37,6	29,6	70,0	59,8	57,7
N(79)	Agjenci Udhëtimi	-20,6	-18,7	3,3	41,4	30,7


Tab. 12 Shifra e afarizmit në volum (e deflatuar), ndryshimi tremujor

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14
		IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi I automjeteve dhe motoçikletave	-3,9	2,8	0,6	-2,5	-3,1
G(46)	Tregtia me shumicë	-21,9	13,8	20,9	7,1	-29,9
H(49-53)	Transport dhe Magazininim	-5,2	10,3	23,6	-40,2	-21,8
I(5500)	Hotele	-31,7	13,9	8,0	-7,2	-16,2
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe Komunikacioni	-29,5	-9,6	22,2	34,1	-19,5
M(71)	Aktivitete të Arkitekturës dhe Inxhinierike	22,6	11,2	10,2	6,4	21,0
N(79)	Agjenci Udhëtimi	-7,9	14,1	17,8	14,2	-14,9

Fig. 7 Indeksi i të Punësuarve me pagesë dhe Pagat për sektorin "Shërbime"



Metodologjia

Informacion

INSTAT si rrjedhojë e detyrimeve që ka ndaj Eurostat, për përshtatshmëri të plotë të statistikave shqiptare me ato të vendeve Europiane, po publikon Indekset e aktiviteteve Industri, Ndërtim, Tregti (përfshirë Tregti me Pakicë) dhe Shërbime, me disa ndryshime metodologjike, të cilat i referohen:

- Aplikimi i Nomenklaturës së rishikuar të aktiviteteve ekonomike, NVE Rev.2;
- Ri-peshimi, përditësohen peshat e përfaqësimit, nga 2005 në 2010
- Ri-referimi, përditësohet periudha referuese nga 2005=100 në 2010=100;

Aplikimi i Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2, bëhet me akt ligjor të miratuar me VKM Nr 320 datë 28.05.2014.

Për më shumë shikoni linkun: http://www.instat.gov.al/media/248316/njoftim_per_media_-_ndryshimi_i_nomenklatur_s_s_veprimtarive_ekonomike_rev_2.pdf

Klasifikimi i rishikuar është në mënyrë të konsiderueshme i ndryshëm nga klasifikimi ekzistues në drejtim të strukturës, klasifikimit dhe trajtimit metodologjik të disa aktiviteteve.

Kalimi i njësive statistikore nga NVE Rev.1.1 në NVE Rev.2 është bërë nëpërmjet ndërtimit të matricës së konvertuar, bazuar në informacionin statistikor të përfutur nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, 2010.

Referuar pikërisht kësaj matrice, disa nga grup-aktivitetet që janë publikuar me NVE Rev.1.1 përgjithësisht kalojnë 100 përqind në grup aktivitete publikimi në NVE Rev.2. Ndryshimet që kryesisht sjellë klasifikimi i ri për aktivitetet përbërëse të fushës së mbulimit të ATN, janë si më poshtë:

- a. Sipas klasifikimit të vjetër (NVE Rev. 1) aktivitetet e "Publikimit" përkojnë me ndarjen 22. Në klasifikimin e ri (NVE Rev. 2) "Aktivitete publikimi" përkon me ndarjen 58, seksioni J, "Informacioni dhe Komunikacioni".
- b. Ndarja 45, që përkon me NVE Rev.1.1 në aktivitetin e "Ndërtimit", detajohet në tre ndarje në klasifikimin e ri, në 41, "Ndërtimi i ndërtesave", 42, "Punime inxhinierike" dhe 43 "Punime të specializuara ndërtimi". Pjesë e ndarjes 41 bëhet edhe grupi 70.1 që përkon në NVE Rev.1.1, me aktivitetin "Aktivitete mbi pasuritë e patundshme".

- c. Aktivitetet e postave dhe korrierës, që përkon në NVE Rev. 1.1, me klasat 64.11 dhe 64.12, kalon në aktivitetin “Transport dhe magazinim”, që përkon në NVE Rev.2 me ndarjen 58, “Aktiviteti i postës dhe korrierës”.
- d. Një tjetër risi e klasifikimit të ri, me ndikim në publikimin e indeksit të statistikave afatshkurtra (tremujore) është edhe ardhja në fushën e mbulimit të aktiviteteve si: “Grumbullimi dhe Trajtimi i mbeturinave”, që përkon me klasifikimin NVE Rev.1.1, ndarja 90. Në klasifikimin e ri, NVE Rev.2, këto aktivitete i përkojnë ndarjes 38, “Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve”. Bëhet pjesë e kësaj ndarje edhe grupi 38.3, që përkon në NVE Rev.1.1, me ndarjen 37, “Riciklimi”.
- e. Në grupin 71.00, që përkon në NVE Rev.2, me “Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike, aktivitete të kontroleve dhe analizave teknike”, përfshihen edhe aktivitete të veçanta të grupeve 74.3 -74.8, që përkon me NVE Rev.1.1 me “Aktivitete të kontrollit dhe analiza teknike”.

Treguesi kryesor i shifrës së afarizmit është përdorur për rivlerësimin e kalimit të aktiviteteve ekonomike nga nomenkatura e vjetër në nomenklaturën e re. Metodatat kryesore të përdorura për vlerësim janë dy:

- Metoda e vlerësimit në nivel mikro
- Metoda e vlerësimit në nivel makro

Metoda e parë, u përdor për tre vitet e para të riklasifikimit të aktiviteteve të njësive në nivel individual në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve, 2010-2012;

Metoda e dytë, u përdor për rivlerësimin e të dhënave në seri kohore pas, për periudhën 2005-2010.

Ri-peshimi – për reflektuar ndryshimet e strukturës së ekonomisë, peshat përditësohen, sipas metodologjisë së statistikave europiane sipas aktiviteteve përfaqësuese, nga 2005 në 2010.

Ri –referim - shprehimisht do të thotë kalimi i indekseve me një periudhë referuese të re, nga 2005=100 në 2010=100. Seritë e të dhënave, të llogaritura me të dy periudhat, janë ekuivalente me njëra-tjetrën: ritmet e rritjes janë të njëjta, dhe një seri mund të konvertohet tek tjetra.

Informacion mbi vrojtimin

Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

Fusha e mbulimit- Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën tremujore pranë ndërmarrjeve janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese
- Ndërtim
- Shërbime, të cilat përbëhen nga Tregtia me shumicë, Hotele, Transport dhe Magazinim, Agjenci udhëtimi, Komunikacion dhe Informacion dhe shërbime të tjera.

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku:

Kampioni për ndërmarrjet me 1 - 9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

Mbledhja e informacionit - Mbledhja e të dhënave bëhet me intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2010=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për aktivitetin hotelier, si dhe Shitjen dhe riparimin e automjeteve. Për aktivitetet e transportit përdoret deflator i llogaritur në mënyrë implicite nga të dhënat administrative. Indekset nuk janë të vlerësuara sezonalisht.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

Përkufizimet e treguesve kryesorë

Shifra e afarizmit - Shifra e afarizmit përfshin shumën e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vërtetohet për periudhën referuese dhe kjo korrespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar.

Indeksi i Shifrës së afarizmit - Objektivi i indeksit të shifrës së afarizmit është të paraqesë ecurinë e tregut për mallra dhe shërbime.

Numri i të punësuarve - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përfshirë të vetëpunësuarit me pagesë).

Indeksi i Numrit të punësuarve - Indeksi i punësimit paraqet ecurinë e punësimit në njësinë e vrojtuar.

Paga dhe trajtime - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimit (në lekë apo natyrë- të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

Indeksi i pagave dhe trajtimeve - Indeksi i pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.